



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



NEWSLETTER

JANAR - MARS 2022

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve boton numrin e parë të revistës për vitin 2022, për periudhën janar-mars.

AIDA ka kthyer në traditë botimin e revistës periodike tremujore. Çdo vit, publikon 4 numra të newsletter-it me informacione të vlefshme për audiencën, grupet e interesit, bizneset dhe publikun më të gjerë. Në formatin e një buletini elektronik, ndarë në disa rubrika, revista pasqyron evente, takime, webinare, sesione informuese/info day, door to door, aftercare, trajnime, vizita, forume, panaire, bashkëpunime, botime e publikime, përditësime dhe informacione të rëndësishme mbi sipërmarrjen, nisma apo fushata të rëndësishme që AIDA ndërmerr.

Secili nga numrat e revistës elektronike është njëherësh një dokumentim që përmbledh aktivitetet përgjatë 3 muajve, një burimi informacioni që shfaq profilin e konsoliduar të AIDA-s dhe fushave që ka në fokus.

AIDA zhvillon veprimtarinë e saj për të fuqizuar zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos me përkrahjen e prodhuesve dhe produkteve vendase. Në funksion të një diplomacie ekonomike, jep kontribut në zgjerimin e bashkëpunimit me vende partnere dhe strategjike nëpërmjet dialogut me institucione që kanë në fokus investimet, rolit aktiv dhe pjesëmarrjes së vazhdueshme në evente që kanë si objektiv promovimin e Shqipërisë në fusha të ndryshme.




Mbështetja dhe asistimi profesional i investitorëve të huaj është një aspekt me prioritet të veçantë. Agjencia, veç tërheqjes së investimeve direkte në vendin tonë, ndërmerr nisma për rritjen e konkurrencës së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), zhvillimin e sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit, punon për promovimin dhe ofrimin e ndihmës për eksportet e mallrave dhe shërbimeve, duke bashkëpunuar me subjektet e tregtisë së jashtme dhe organet shtetërore.

Në ndihmë të bizneseve vendase dhe produkteve 'Made in Albania', AIDA vijon fushatën promovuese 'E Dua Shqip'.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve është proaktive dhe ka si përparësi mbështetjen e interesave ekonomike të Shqipërisë, tërheqjen e investimeve të huaja, promovimin e vendit si destinacion i veçantë dhe i qëndrueshëm turistik, si partner i besuar tregtar/i investimeve të huaja në sektorë potencialë si energjia, turizmi, infrastruktura, bujqësia etj., si dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të brendit shqiptar.

Për të rejtat më të fundit mbi Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve vizitoni:

 @aida__albania  AIDA - Albanian Investment Development Agency

 info@aida.gov.al  aida.gov.al  +355 (0)42 251 001  @investinalbania

 AIDA - Albanian Investment Development Agency



AIDA TEAM | KONTAKT

email: info@aida.gov.al

tel: +355 042 251 001

web: www.aida.gov.al

Dorëzimi i aplikimeve ose dokumenteve për statusin e Investitorit Strategjik;
Dokumente të çfarëdollojshme, të cilat mund të përcillen nëpërmjet:

- Postës Shqiptare;
- E-mailit: info@aida.gov.al
- Pranë zyrave të AIDA-s

Për çdo informacion, ju lutem vizitoni faqen web www.aida.gov.al dhe rrjetet tona sociale të përditësuara.

EXPO 2020 DUBAI, NJË MUNDËSI PËR TA PARË BOTËN NDRYSHE PAS PANDEMISË

NJË BOTË E BASHKUAR DHE INOVATORE

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2022, Shqipëria ishte pjesë e panairit botëror Expo 2020 Dubai, nëpërmjet pavijonit të dedikuar në zonën e Lëvizshmërisë, e cila kishte në fokus krijimin dhe prezantimin e urave lidhëse fizike dhe virtuale, produktive për lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe ideve, duke siguruar qasje më të lehtë në tregje, njohuri dhe inovacion.


Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në rolin e institucionit koordinues, e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Sokol Nano, në rolin e Komisarit të Përgjithshëm të Shqipërisë, ka menaxhuar dhe administruar Pavijonin Shqiptar në panairin ndërkombëtar Expo 2020 Dubai, e cila ka tërhequr vëmendjen e vizitorëve të shumtë për mrekullitë natyrore dhe mundësitë e shumta që ofron vendi ynë.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në EXPO 2020 Dubai me një kohëzgjatje 6-mujore, filloi më 1 tetor 2021, deri më 31 mars 2022, duke bërë bashkë 192 shtete.

Pjesëmarrja në Expo 2020 Dubai, kulmoi me Ditën Kombëtare, më datë 9 mars 2022.

Për të vizituar virtualisht pavijonin e Shqipërisë klikoni linkun:

<https://www.facebook.com/watch/?v=438744874399449>



EVENTE NË EXPO DUBAI 2020



AIDA ORGANIZOI PJESËMARRJEN E NJË DELEGACIONI BIZNESI NË EXPO 2020 DUBAI

AIDA, në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (CCIT), në kuadër të Javës së Ushqimit, Bujqësisë dhe Jetesës, në Expo 2020 Dubai, organizuan në datë 26 Shkurt, eventin “Taste Albania” në Dubai.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishte një delegacion biznesi i përbërë nga 19 kompani shqiptare, si edhe kompani të huaja, dhoma tregtie dhe organizata biznesi nga shtete të ndryshme.

Ky event bëri bashkë kompani prodhuese, eksportuese dhe tregtar të industrisë së ushqimit, duke dhënë mundësinë e krijimit të kontakteve të reja, me synimin e krijimit të kontratave të bashkëpunimit.

Gjithashtu, bizneset shqiptare të udhëhequr nga Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, në cilësinë edhe të Komisarit të Përgjithshëm të Pavijonit të Shqipërisë në Expo 2020 Dubai, zhvilluan vizita në pavijonet e disa shteteve pjesëmarrëse në Expo 2020 Dubai.



DITA KOMBËTARE E SHQIPËRISË NË EXPO 2020 DUBAI

CEREMONIA E DITËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË NË EXPO 2020 DUBAI

Pjesëmarrja e Shqipërisë në EXPO 2020 Dubai për periudhën 6-mujore, bashkë me 192 shtete, kulmoi me Ditën Kombëtare më datë 9 mars.

Kjo ditë e rëndësishme bëri bashkë vizitorë të pavijonit të Shqipërisë dhe miq e dashamirës të vendit tonë. Shqipëria ishte në qendër të organizimeve, ku gjatë gjithë ditës u mbajtën performanca të ndryshme kulturore.

Ditën Kombëtare e nderoi me pjesëmarrjen e tij Kryeministri i vendit, Z. Edi Rama dhe një pjesë e kabinetit qeveritar. Z. Rama përshëndeti organizimin dhe e vuri rëndësinë e fjalës së tij të marrëdhëniet shumë të mira mes Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Shqipërisë. Gjithashtu, Kryeministri theksoi edhe rëndësinë e pjesëmarrjes në evente të tilla si expo, në zhvillimin e metejshëm të bashkëpunimeve dhe marrëdhënieve mes shteteve.

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, Z. Sokol Nano, në rolin edhe të Komisarit të Përgjithshëm të Shqipërisë në Expo 2020 Dubai, e vlerësoi pjesëmarrjen në këtë event mbarëbotëror me rëndësi të veçantë në marrëdhëniet ekonomike dhe investimet që priten të jetësohen në vendin tonë.



Deri më 31 Mars 2022, pavijonin e Shqipërisë e vizituan mbi 430 mijë vizitorë nga e gjithë bota.

Gjatë kësaj periudhe, pavijoni i Shqipërisë u vizitua nga Ministrja për Zhvillimin e Komunitetit të Emirateve të Bashkuara Arabe, Shkëlqesia e saj Hessa Bint Essa Bhumaid dhe nga Zv.Ministrja e Punëve të Jashtme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Znj. Fatmire Isaki. Përfaqësuesit shprehën vlerësimet për pavijonin dhe Shqipërinë, si një vend me pozicion strategjik të favorshëm, potencial zhvillimi në disa sektorë, si edhe me natyrë, kulturë dhe traditë të pasur.



NGA INTERVISTA E DREJTORIT EKZEKUTIV TË AIDA-S, Z. SOKOL NANO, DHËNË PËR RADIO TELEVISION SHQIPTAR, ME RASTIN E DITËS KOMBËTARE

Për të ndjekur intervistën e plotë, klikoni linkun:

<https://www.facebook.com/investinalbania/videos/1569160166816621>



SHQIPËRIA NË EXPO DUBAI 2020

200 mijë vizitorë në pavionin shqiptar



AIDA

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA), është pjesë e aparatit organizativ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

AIDA shërben si një nyje lidhëse mes investitorëve të huaj dhe Qeverisë së Shqipërisë. Qëllimi i saj është të ndërmarrë nisma të vazhdueshme që gjenerojnë rritje të qëndrueshme ekonomike, biznese të zhvilluara, mundësi për tërheqjen e investimeve të huaja në përputhje me profilin e burimeve dhe aspiratat e Shqipërisë.

AIDA është promotore e markës “Made in Albania”. Në misionin e vet, vijon të mbështesë bizneset vendase duke zhvilluar sidomos sektorët prioritarë.

Gjatë vitit 2020 AIDA ka dhënë mbështetje konkrete ndaj biznesit vendas, ka ndikuar në thjeshtimin e procedurave për investitorët e huaj, vendosjen e bashkëpunimeve të reja dhe të suksesshme me institucionet, në ndihmë të klimës së investimeve; përçimin e informacionit të përditësuar për investitorët e huaj dhe ata vendas; realizimin e disa “outreach campaign” në sektorët potencialë, realizimin e disa pyetësorëve për kompanitë që kanë investuar në Shqipëri për t’u njohur me nevojat e tyre për përmirësimin e klimës së biznesit.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve shënjon një strategji novatore, një vizion të ri në mënyrën e qasjes dhe zhvillimit të potencialit ekonomik të Shqipërisë.



FUSHATA #EDUASHQIP NË MBËSHTETJE TË BIZNESEVE SHQIPTARE DHE PRODUKTEVE ‘MADE IN ALBANIA’

AIDA, si një pikë qendrore për sipërmarrjen është gjithmonë në mbështetje të prodhuesve shqiptarë, që gjithnjë e më shumë po shtojnë produkte nën markën “Made in Albania”, duke ofruar për tregun vendas dhe atë të huaj cilësi dhe vlerat tona tradicionale. E Dua Shqip është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve/AIDA në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve ‘Made in Albania’.

Qëllimi ynë është të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare. T’i japim jetë artizanatit, produkteve autentike dhe unike duke bërë bashkë çdo copëz që formon historinë e Shqipërisë me vlera. Kjo nismë synon të krijojë një katalog sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës. Nëse jeni një biznes apo artizan, prodhoni të mira nga duart tuaja, doni t’i prezantoni dhe t’i ktheni në një “atraksion turistik” për vendin e origjinës, na dërgoni përshkrimin dhe foto të produktit. Rrënjët janë të rëndësishme.

Nëse dëshironi të bëheni pjesë e kësaj fushate, na kontaktoni në info@aida.gov.al ose në numrin e telefonit 04 225 1001.



zojdh të vendit

'Ador'

Linja e kujdesit për lëkurën 'Ador' 'Ador' është një linjë e perkushtuar plotësisht ndaj perkujdesjes për lëkurën dhe flokët e foshnjave dhe femijëve. 'Ador' prodhon produkte delikate me përbërës të më të butë e të mirëmenduar për mirëmbajtjen e lëkurës në rritje dhe flokët e parë të të vegjëlvë që nga lindja e deri në adoleshencë. Linja e foshnjave dhe linja e femijëve prezantojnë produkte respektive si: shampo, qumësht flokësh, kremëra, të menduara për këto moshë, me përbërës si: Aloe Vera, kamomil, bajame, etj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: ador.care@gmail.com ose në 0692426125.



zojdh të vendit

'BioJet'

'BioJet' është linja e kozmetikës tërësisht natyrale, e prodhuar në mënyrë artizanale. Kjo linjë kozmetike i është dedikuar kujdesit të shëndetit në çdo detaj duke u fokusuar në bashkimin me natyrën. Përdorimi i produkteve me përbërës natyrale dhe të certifikuar, janë risia që 'BioJet' sjell. Linja personalizon formula sipas tipologjisë së lëkurës dhe flokëve për tu ndjerë unike dhe të shëndetshëm.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info.biojet@gmail.com ose në +35567201145.



zojdh të vendit

Bletari 'Bio Bleta'

Në Durrës 'Bio Bleta' kujdeset që të sjellë mjaltin organik, me pasion dhe perkushtim. Bletët nga merret mjalti 'Bio Bleta' shtetojnë për kullotë në fshatin Shepër, në krahinën e Zagorisë. Mjalti organik 'Bio Bleta' është tërësisht natyral, pa kimikate në mënyrë që të mos humbë shija e vërtetë e mjaltit. Përveç mjaltit, 'Bio Bleta' prodhon edhe qumësht blete, propolis dhe polen lulesh.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 0675936900ose në eraldnano1978@gmail.com.



zojdh të vendit

Prodhime bulmeti 'Feaksi'

Fabrika e përpunimit të qumështit 'Feaksi' e vendosur në Fier, prodhon produkte bulmeti të ndryshme të freskëta si: djathë të bardhë, kackavall, kos etj.. të certifikuar sipas Autoriteti Kombëtar të Ushqimit. Fabrika 'Feaksi' ofron në treg produkte cilësore, dhe 100% bio.Qumështi dhe produktet e qumështit sigurojnë sasinë e duhur të kalciumi dhe këto vlera ushqyese kontribuojnë direkt në shëndetin e kockave, lëkurës dhe forcojnë sistemin imunitar.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 0692777070 ose në ilirlalaj@hotmail.com.



zojdh të vendit

'Buna Farm'

Në Shkodër që nga viti 1994, kompania 'Buna Farm' merret me përpunimin e qumështit duke sjellë në treg prodhime tepër të shijshme dhe cilësore. Vit pas viti kompania 'Buna Farm' ka rritur kapacitetet e saj të prodhimit nga kërkesa e lartë e shijes dhe cilësisë. Djathi i bardhë dhe kackavall lope dhe dhie është produkti klasik por me një shije krejtësisht të veçantë nga të tjerët, pasi mbart në vetvete traditën e 'Buna Farm'.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355682033031 ose në redi.bunafarm@hotmail.com.



zojdh të vendit

Essa Beauty

'Essa Beauty' është një linjë kujdesi ndaj vetes, trupit dhe flokëve e krijuar për çdo grua që dëshiron të kujdeset për veten. Ajo është një linjë unike, 100% organike dhe e certifikuar sipas standardeve europiane, me cilësi maksimale. Secili prej produkteve është një formulim unik, pasi i është kushtuar rëndësi çdo detaj. Të gjitha produktet e 'Essa Beauty' kanë në bazë eliksirin e bukurisë së përjetshme, vajin e arganit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355695504500 ose në info@essabeautywellness.com.



Kantina e Pijeve "Asllani"

Kantina e Pijeve "Asllani" është një kompani që operon prej vitesh, në qytetin e Durrësit. Procesi i prodhimit në kantinë drejtohet nga enologë me përvojë të gjatë dhe me eksperiencë të gjërë. Produktet e kantes janë cilësore dhe të vlerësuar nga degustatorë të njohur të huaj dhe vendas. Larmishmëria e produkteve përfshin fernetin aromatik, konjakun embleme dhe verat e ndryshme shumë karakteristike.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355693767636 ose në kantina.asllani@gmail.com.



Kantina 'CACO'

Kantina 'CACO' ndodhet në zonën jugore të qytetit të Pogradecit, në një lartësi 780-850 metra mbi nivelin e detit. Mikroklima shumë e favorshme bën të mundur rritjen e një vreshiti shumë cilësor. Teknologjia e disponuar nga kantina 'CACO' është bashkëkohore për të gjithë hapat e prodhimit dhe ambalazhimit të verës. Aktualisht kantina 'CACO' ka 5 etiketa vere: dy verë të bardhë, një rozë, dy të kuqe dhe dy etiketa rakie, Perla dhe Muskat.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355692052801 ose në info@kantinacaco.com.



Çaj 'Natural Herbal E.V.R.'

'Natural Herbal E.V.R.' është një kompani krijuar që prej vitit 1993, e cila merret me grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e çajit dhe bimëve mjekësore aromatike të thata. Kompania është e vendosur në Maliq, në një pozite geografike të rëndësishme për lidhjet tregtare dhe bën të mundur mbledhjen e rreth 100 llojeve të ndryshme bimësh. 'Natural Herbal E.V.R.' është një kompani e certifikuar sipas standardeve europiane dhe eksporton në vende të ndryshme prej disa vitesh.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355684020205 ose në info@naturalherbalv.al.



Produkte bulmeti 'SHAKA'

Fabrika e përpunimit të qumështit "SHAKA" e pozicionuar në fshatin Boboshticë, në Korçë, e ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1996 duke nisur si një biznes i vogël familial. Aktiviteti i fabrikës është prodhimi i djathit të bardhë (lopes, dele, dhise), kaçkavalli i lopes dhe i deles dhe gjithashtu nënproduktet si gjalpi dhe gjiza. Pajisjet e përpunimit të qumështit janë të teknologjisë më të fundit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 0682068722 ose në shakaboboshtice@gmail.com.



Ujë 'Bukaniku'

Burimi i ujit 'Bukaniku' gjendet në malin e Bukanikut, në fshatin Gjinar të Elbasanit. Me teknologjinë më efektive në fushën e ambalazhimit ka sjelle vlerat natyrale të ujit 'Bukaniku', duke e përdorur në vlera minimale plastiken. I gjendur në lartësinë 1650 metra, burimi i Bukanikut ka disa prej treguesve kimike më të mirë në Shqipëri, pasi është shumë i pasur me magnez. Uji 'Bukaniku' është i certifikuar me standard et e cilësorisë dhe ruan vlerat e freskisë së ujit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +35554830373 ose në info@bukaniku.com.



Ujë 'Qafthana'

Kompania e prodhimit dhe përpunimit të ujit natural 'Qafthana' është e vendosur në rrëzë të malit Shebenik, në Prrenjës. Nga burimet e rralla akullnajore të Rrajcës buron uji 'Qafthana' në lartësinë 2200 m mbi nivelin e detit. Uji natural 'Qafthana' është i pastër bakteriolgjikisht dhe i certifikuar sipas standardeve të cilësorisë. Uji i nënshtrohet një procesi teknologjik për pastrimin dhe sterilizimin e tij sipas standardeve të BE.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 0696599920 ose në ujeqafthana@yahoo.com.






Ujë 'Shpati'

Kompania 'Shpati' sh.p.k, e themeluar në vitin 2011 ka investuar duke ngritur fabrikën e ujit mineral 'Shpati', në fshatin Dërstilë, Elbasan. Shija e ujit 'Shpati' ka një karakter unik, pasi zona ku buron është e mbështjellë me pisha tërësisht të gjelbëruara duke e ruajtur këtë burim nga ndotja e faktorëve të jashtëm. Uji i nënshtrohet proceseve të filtrimit dhe ambalazhimit sipas të gjitha standardeve teknologjike, për të garantuar cilësi maksimale tek konsumatorët.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355694401200 ose në shpati.water@hotmail.com.






Vaj Ulliri 'Borneo'

Varietetet e ullinjve të rritur në Shqipëri janë indigjene, kështu ata përshatën me tokën, klimën dhe metodat e kultivimit të vendit. Fabrika 'Borneo' e vendosur afër Tiranës, përdor varietetin e ullirit kalinjot për të prodhuar ullirin ekstra të virgjër 'Borneo'. Në këtë fabrikë përdoret teknologjia më e fundit dhe që i reziston kohës për të përpunuar ullirin dhe prodhuar vajin e ullirit. Fabrika 'Borneo' identifikohet me profesionalizmin, cilësinë dhe dërbimin e nivelit të lartë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +35569400090 ose në bornemuka.bm@gmail.com.








Vaj ulliri 'Borsh'

Kompania 'S.E.D Borsh' sh.p.k ka filluar aktivitetin e saj në maj të vitit 1992, në fshatin Borsh të Sarandës, për prodhimin e vajit të ullirit 'Borsh'. Kompania operon në fushën e prodhimit, përpunimit, paketimit dhe tregtimit të vajit të ullirit në të gjithë Shqipërinë. Kompania 'S.E.D Borsh' sh.p.k eksporton në: Kosovë, Zvicër, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kenia, Maqedoninë e Veriut dhe SHBA.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: vaj_ulliri_borsh@yahoo.com ose në 0694045906.



Vaj Ulliri 'Çuedari'

Në Berat kompania 'Çuedari' prej shumë vitesh merret me grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e ullirit. Vaj ulliri 'Çuedari' eksportohet në disa vende të rajonit, përveçse në tavolinat shqiptare. Prodhimin e vajit të ullirit ekstra të virgjër, realizohet me përkushtim dhe me teknologjitë më të fundit bashkëkohore. Vaj ulliri 'Çuedari' plotëson të gjithë kushtet dhe standardet europiane, për t'u konsideruar vaj ulliri i cilësisë së lartë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355682069392 ose në kcuedari@hotmail.com.






Vera 'Alpetra'

E rrethuar me kodrina poshtë malit Tomorr shtrihet fshati Roshnik, i rrethuar me vreshta, të cilat rrethojnë kantinën 'Alpetra'. Vera 'Alpetra' ka bërë një rrugë të gjatë në kohë për cilësinë e saj. Vera është një përzierje merlot-kabernet, e stazhonuar në fuçi. Disa nga llojet e verës që kantina ofron janë autoktonin shqiptar, shesh i zi, rrush dimeror si dhe disa varietete të njohura ndërkombëtarisht si: kabernet, merlot dhe muskat.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: alpetawinery@gmail.com ose në +355697484361.






Vera 'Belba'

Kantina 'Belba' e vendosur në Kavajë, ruan traditën disa vjeçare të kultivimit të rrushit dhe prodhimit të verës. Vera 'Belba' është e njohur për cilësinë që e karakterizon, shijen e pakonkurrueshme dhe finesën plot sharm. Vera e kantinës 'Belba' është kurorëzuar në arenën ndërkombëtare me çmime prestigjioze. Vera 'Kavalijon Sheshi i Zi 2015' dhe vera 'Kavalijon Chardonnay 2018' e kantinës 'Belba' është vlerësuar me medalje të argjendtë, mes verave më të mira të Ballkanit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: kantinelbelba@gmail.com ose në 0684011136.



AIDA agjencia shqiptare e zhvillimit te investimeve

zgjijdh të vendit

Vera 'Isak'

Kantina 'Isak' është e vendosur në Delvinë, që në vitin 1992 dhe ka marrë emrin e një komuniteti të vogël izraelit që merrej me përpunimin e rrushit në të njëjtën zonë shumë kohë më parë. Falë pozicionit gjeografik dhe varieteteve autoktone, kantina prodhon rreth 9 lloje verash si Shesh i Bardhë, Shesh i Zi, Merlot, Riesling, Moskat, etj. Vera 'Shtëpi e Vjetër e Kuqe' është një specialitet i kantinës, i cili prodhohet me ajkën e rrushit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355676872160 ose në kantinaisak@gmail.com.



AIDA agjencia shqiptare e zhvillimit te investimeve

zgjijdh të vendit

Vera 'Kokomani'

Kantina e verës Kokomani është e vendosur në kodrat e Eminasit, në Shijak. Ferma Kokomani u themelua fillimisht në vitin 2010 si një kantine vere duke prezantuar në tregun shqiptar tri llojet e verërave: Shesh i Zi, Shesh i Bardhë dhe Saint Michael (Shën Mhill). Verat e prodhuara janë të një cilësie shumë të lartë dhe janë të vlerësuar me një sërë çmimesh. Që nga viti 2014, kantina Kokomani mban vulën e cilësisë, si një produkt i garantuar.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355692050870 ose në kokomaniwinery@gmail.com.



AIDA agjencia shqiptare e zhvillimit te investimeve

zgjijdh të vendit

Vera 'Vila Hadaj'

Kantina "Vila Hadaj" ndodhet 17 km nga qyteti i Beratit, e ndërtuar në mes të vreshtave të zonës së njohur të Malinatit. Veçori tërheqëse për kantinën është investimi në natyrë, larg zhurmave, ndotjes dhe në zëmër të natyrës, aty ku lulëzojnë vreshtat që prej vitit 1970. Vreshtat cilësorë kultivohen për të dhënë një produkt me kualitet dhe origjinalitet i cili ruan vlerat dhe karakteristikat e zonës. Vera është sipas standardeve duke ndërthur teknologjinë me traditën.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355696481987 ose në cimihadaj@yahoo.it.



AIDA agjencia shqiptare e zhvillimit te investimeve

zgjijdh të vendit

Violina nga Eri Gurra

Arti i Luterisë është një mjeshteri sa unike aq dhe e veshitur, e cila kërkon një aftësi manuale në punimin e drurit, një dije të fizikës akustike dhe njohuri të instrumentave me harqe. Eri Gurra që nga viti 2010 ka hapur laboratorin për ndërtim dhe restaurim të violinave, violave, etj., në Tiranë. Violinat që ai ndërton mbajnë njohuritë dhe ndjesitë e trashëguara të mjeshtërve më të mëdhenj të historisë si Stradivari, Amati e Guarneri.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355693112107 ose në info@erligurra.com.

THIRRJE TË REJA



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mirëmban dhe përditëson me skema të reja financiare platformën "Akses në Financë", duke ofruar informacionin më të fundit mbi mundësitë e burimet financiare për NVM-të në Shqipëri. AIDA kujdeset që thirrjet e publikuar në platformë <https://aida-smefinance.gov.al/> të përmbajnë të dhënat thelbësore dhe të jenë shteruese në përcjelljen e informacionit për të orientuar një aplikim të suksesshëm dhe për të përmbushur në këtë mënyrë misionin që ka në mbështetje të biznesit vendas.

SUSTAINABILITY PARTNERSHIPS FOR SME ADOPTING MORE SUSTAINABLE PRACTICES

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "Sustainability Partnership for SMEs Adopting more Sustainable Practices". Objektivi i përgjithshëm i kësaj thirrje për propozime trajtimi i ekspertizës së OJF-ve, për të mbështetur SME-të në shndërrimin e tyre në modele biznesi më të përshtatshme nga projekte/veprime që mund të bëjnë dëme në mjedis. Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../sustainability...>

CAPACITY BUILDING IN THE FIELD OF YOUTH

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "Capacity Building in the Field of Youth". Qëllimi i thirrjes është ngritja e kapaciteteve të organizatave që punojnë me të rinjtë, promovimi i aktivitetit të mësuarit joformal dhe mbështetjen e zhvillimit të punës për të rinjtë në vendet e treta që nuk janë të lidhura me Programin.

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../capacity-building-in...>

SUSTAINABLE CAPACITY NETWORKS

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "Sustainable Capacity Networks". Objekti i kësaj thirrje fokusohet në kërkesat e reja të transportit të adresuara nga përparimet teknologjike në rrjetet optike, duke përfshirë konfigurimin në distancë në nivelin e pajisjes.

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../sustainable-capacity...>

Up2Europe

Ideas Partners Consultants

Home > Calls > Sustainability Partnerships for SMEs adopting more sustainable practices

Sustainability Partnerships for SMEs adopting more sustainable practices

Deadline: Mar 15, 2022
- 68 days

INTERESTED ON THIS CALL? SUBMIT AN IDEA!

EC - SINGLE MARKET PROGRAMME (SMP)

2 | Comment Share Follow

Programme	Work programme part	
Erasmus+ Programme (ERASMUS)	ERASMUS-2022	
Call	Work programme year	
Capacity Building in the field of Youth (ERASMUS-YOUTH-2022-CB)	ERASMUS-2022	
Type of action	Type of MGA	
ERASMUS-LS ERASMUS Lump Sum Grants	ERASMUS Lump Sum Grant [ERASMUS-AG-LS]	
Deadline model	Opening date	Deadline date
single-stage	25 November 2021	07 April 2022 17:00:00 Brussels time

Sustainable Capacity Networks

Deadline: Apr 26, 2022
- 19 days

INTERESTED ON THIS CALL? SUBMIT AN IDEA!

EC - HORIZON EUROPE

Comment Share Follow

OPEN CALL FOR TENDER PREQUALIFICATION

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "Open Call for Tender Prequalification".

Qëllimi i thirrjes ka të bëjë me asistencën teknike/këshillimore për institucionet financiare për ofrimin e produkteve kreditore për NVM-të, si dhe për bizneset e reja NVM në lidhje me aksesin në finance ose produkte financiare.

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../sustainable-capacity..>



EIC TRANSITION CHALLENGE: PROCESS AND SYSTEM INTEGRATION OF CLEAN ENERGY TECHNOLOGIES

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "EIC Transition Challenge: Process and System Integration of Clean Energy Technologies". "EIC Transition Challenge" synon efikasitetin e teknologjisë së propozuar të energjisë përmes integrim-it të saj në një sistem energjetik plotësisht funksional dhe shfaqjes së aktorëve të ekosistemit dhe zinxhirit të vlerës që nevojiten për përvetësimin e teknologjisë në treg.


Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../eic-transition...>



PILOT EUROPEAN INNOVATION GENDER AND DIVERSITY INDEX

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "Pilot European Innovation Gender and Diversity Index". Qëllimi i kësaj thirrje është të arrihet identifikimi i pabarazive gjinore, diversitetit dhe hartimi i masave përkatëse si dhe vlerësimi i progresit në të gjithë nivelet e ekosistemit të inovacionit.

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/.../pilot-european...>



EIC ACCELERATOR OPEN

AIDA, njoftoi se është hapur thirrja: "EIC Accelerator Open". "EIC Accelerator Open" mbështet zhvillimin teknologjik dhe fokusohet në ndërtimin e risive në zbulimet shkencore ose teknologjike.

Vizitoni platformën Akses në Financë: <https://aida-smefinance.gov.al/finan.../eic-accelerator-open>



TAKIME



AIDA PRET NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E AGJENCIVE HOMOLOGUE TË KOSOVËS DHE MAQEDONISË SË VERIUT

Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, mirëpriti në një takim përfaqësuesin e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Z. Zef Dedaj dhe përfaqësuesin e Invest North Macedonia, Z. Bekim Emini. Takimi u zhvillua në kuadër të prezantimit njohës dhe nxitjes së bashkëpunimit mes institucioneve. Gjatë takimit përfaqësuesit ndanë përvojën e tyre në lehtësimin dhe tërheqjen e investimeve të huaja dhe mbështetjen e ofruar ndaj kompanive vendase.

Në përfundim të takimit u dakordësua për fillimin e punës mbi nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi në të ardhme, me synim zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe krijimin e partneriteteve.



AIDA NIS BASHKËPUNIMIN ME DHOMËN E TREGTISË ZVICËR-SHQIPËRI (SWISSA)

Përfaqësues të AIDA-s, pritën në një takim përfaqësuesit e Dhomës së Tregtisë Zvicër-Shqipëri (SWISSA), më datë 02 shkurt 2022. Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e përbashkët në përkrahjen e bizneseve shqiptare dhe atyre zvicerane, zhvillimin e sektorëve strategjik, si dhe tërheqjen e investitoreve në Shqipëri.

Gjatë takimit u dakordësua në krijimin e takimeve dypalëshe të bizneseve zvicerane në Shqipëri, si dhe atyre shqiptare në Zvicër. Gjithashtu, u diskutua zhvillimi i projekteve duke u fokusuar te kompanitë zvicerane ose në partneritet me Zvicrën.



AIDA, PJESË E TAKIMIT ME TEMË: "TREGTIA ELEKTRONIKE NË SHQIPËRI"

Përfaqësues nga AIDA, morën pjesë në takimin e organizuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë të Shqipërisë, në bashkëpunim me Forumin e Investimeve të 6 Dhomave të Ballkanit Perëndimor (WB6CIF) dhe me mbështetjen e Komisionit Evropian.

Ky takim bëri bashkë aktorët më të rëndësishëm në tregtinë elektronike si: institucione, donatorë dhe sipërmarrës, për të ofruar informacionet dhe praktikën më të mira për të zhvilluar më tej sektorin e tregtisë elektronike në vendin tonë, duke e parë atë edhe si një sektor të integruar në Tregtinë e Përbashkët Rajonal (Common Regional Market-CRM), ku Bashkimi i Dhomave të Tregtisë është aktor për implementimin së bashku edhe me dhomat e tjera kombëtare të WB6.



EVENTE



STUDY TOUR NË PANAIRIN “SICUR MADRID”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me SIPPO Albania dhe shoqatën Pro Export Albania, organizuan një Study Tour në panairin “SICUR Madrid” në datat 22 – 25 shkurt. Qëllimi i organizimit të këtij Study Tour-i ishte studimi i tregut spanjoll për Industrinë Tekstile & Lëkurë-Këpucë, në kuadër edhe të përgatitjes për pjesëmarrje me standë në panairin SICUR Madrid 2024, për prezantimin e brandit “Made in Albania” në sektorin e veshjeve të punës.

Gjatë Study Tour-it, u zhvilluan takime me përfaqësues të Dhomës së Tregtisë Madrid, Shoqatës së Prodhuesëve të Sektorit të Veshjeve, Madrid, si dhe organizatorët e panairove ndërkombëtare SICUR dhe Momad.



NJOFTIME MBI PANAIRET



DITËT E BUJQËSISË 2022

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi se në datat 19-21 Maj 2022, Iceberg Exhibitions do të organizojë "Ditët e Bujqësisë 2022", Panairin Ndërkombëtar të Bujqësisë, Teknologjive, Ushqimit dhe Përpunimit, në Lushnjë. Ky event do të organizohet me mbështetjen e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Qëllimi kryesor i këtij panairi është krijimi i një platforme komunikimi për bizneset për të nxitur partneritete të reja dhe për të forcuar partneritetet ekzistuese.

Në panair do të marrin pjesë kompanitë më të mëdha dhe aktorët më të rëndësishëm të sektorit nga Shqipëria, Ballkani dhe Evropa. Gjatë tre ditëve të panairit, do të organizohen aktivitete si: konferenca, workshop-e, etj., me synimin për të përcjellë informacione të rëndësishme mbi programet e mbështetjes së qeverisë për bujqësinë, eksportin e produkteve bujqësore, standartet e sigurisë ushqimore dhe gjithashtu, për të vënë theksin tek inovacioni teknologjik në bujqësi si një ndër avantazhet kryesore të së ardhmes së afërt.

SUSTAINABLE INDUSTRIAL MANUFACTURING (SIM) EUROPE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi se në datat 28 – 29 qershor 2022, do të mbahet Konferenca dhe Ekspozita B2B me temë: "Sustainable Industrial Manufacturing (SIM) Europe", në Qendrën e Ekspozitave të Brukselit. SIM Europe ka si qëllim të ndihmojë prodhuesit e mëdhenj të katër sektorëve të rëndësishëm të qelqit, çelikut, kimikateve dhe aluminit, që të përshpejtojnë procesin e çuarjes drejt zeros të emëtimit të karbonit. Gjithashtu, t'i lidhin prodhuesit me furnitorët dhe ofruesit e shërbimeve, që mund t'i asistojnë në dekarbonizimin e operacioneve/proceseve të punës, për një qëndrueshmëri që do të kalojë provat e së ardhmes.

Për pjesëmarrje ose më shumë informacion mbi panairin vizitoni faqen: www.SustainableIndustrialManufacturing.com.

FOOD AND BEVERAGE FOR TOURISM

AIDA, njoftoi se në datat 27 prill dhe 11 maj 2022, në Bullgari do të mbahet aktiviteti i Blue Summer në kuadër të Panairit “Food and Beverage for Tourism”. Panairi konsiston në 3 aktivitete të ndryshme: Blue Summer, Modern City dhe White Winter, që do të organizohen në periudha të ndryshme kohore të vitit 2022. Blue Summer ka si fokus, promovimin e produkteve dhe shërbimeve në fushën e turizmit.

Aktiviteti Blue Summer ofron mundësinë për kontakte të drejtpërdrejta me sipërmarrës të ndryshëm për gjetjen e partnerëve strategjikë, prezantimin e produkteve, takime të platformave B2B, identifikimin e partnerëve të mundshëm, forcimin e partneriteteve, si dhe një orientim më të detajuar për tregun turistik.

Për më shumë informacion rreth aktivitetit, pjesëmarrjes dhe regjistrimit, klikoni linkun: www.hnt-bg.com.



FORUMI I INVESTIMEVE NË TURIZËM – TIF 2022, 16 MAJ 2022, STAMBOLL

AIDA, njoftoi se më datë 16 maj 2022, Shoqata Turke e Investitorëve të Turizmit (TTYD), do të organizojë “Forumit e Investimeve në Turizëm – TIF 2022”, Stamboll. Forumi do të bëjë bashkë investitorë evropianë dhe të Lindjes së Mesme, që operojnë në sektorin e turizmit dhe më gjerë.

Ky forum do të shërbejë si një platformë e shkëlqyer për takime B2B të nivelit të lartë, si edhe një network për të diskutuar projekt ide dhe mundësi investimi në të ardhmen.

Për më shumë informacion, vizitoni linkun: https://tif.com.tr/en_US/.



PANAIRI I BUJQËSISË “AGRITEQ 2022”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi së në datat 10 - 14 mars 2022, u zhvillua Panairi i Bujqësisë “AgriteQ 2022”, në Doha, Katar. Pjesëmarrësit në panair prezantuan produktet në katër fusha: Bujqësi, Blegtori, Industrinë ushqimore dhe Pajisjeve teknologjike për ambientin.

AgriteQ 2022 ofroj mundësi për shkëmbimin e eksperiencave, krijimin e kontakteve të bashkëpunimit dhe njohjen me pajisjet më të fundit teknologjike në ndihmë dhe përmirësim të biznesit të tyre.



PANAIRI NDËRKOMBËTAR I INDISË PËR QERAMIKËN DHE MATERIALEVE TË NDËRTIMIT

AIDA, njoftoi se në datat 8 - 11 Mars 2022, u zhvillua online, Panairi Ndërkombëtar i Indisë për Qeramikën dhe Materialeve të Ndërtimit. Qëllimi kryesor i këtij panairi ishte promovimi i tregtisë dypalëshe midis Indisë dhe vendeve evropiane në përgjithësi, si dhe me Shqipërinë, Moldavinë dhe Rumaninë në veçanti.

Gjatë panairit u zhvilluan edhe takime virtuale B2B, me 30 pjesëmarrës eksportues indianë dhe më shumë se 1000 importues ndërkombëtarë, duke ofruar mundësinë e krijimit të urave të bashkëpunimit.



SFIDA E MADHE DETARE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), njoftoi se do të zhvillohet konkursi ndërkombëtar me temë: “Sfida e madhe detare”, në fushën e teknologjisë së robotëve dhe të sistemeve të tjera autonome, që po adoptohen gjithnjë e më shumë në fusha dhe aspekte të tjera të ndryshme të jetës. Konkursi ka si qëllim rritjen e interesit teknologjik të kompanitë, institucionet apo individët, që në mjedise dinamike, të pa strukturuara, të punojnë robotë në mënyrë më autonome.

Mohamed Bin Zayed International Robotics Challenge” (MBZIRC), do të mbahet në 2023, në Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe drejtohet nga ASPIRE, shtylla e menaxhimit të programit të Këshillit të Kërkimit të Teknologjisë së Avancuar të Abu Dhabit.

Për më shumë informacion klikoni linkun: <https://www.mbzirc.com>.




BOTIME



UDHËZUESI “SI TË NISËSH NJË BIZNES E-COMMERCE”

Si të nisësh një biznes e-commerce - Ky botim u vjen në ndihmë Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), Startup-eve dhe palëve të interesuar në zhvillimin e tregtisë elektronike. Udhëzuesi përfshin të gjithë hapat e rëndësishëm për planifikimin, dizejnimin dhe zhvillimin e tregtisë elektronike, duke e bërë produktin më të njohur në tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Ju informojmë që ky udhëzues do të jetë subjekt i përditësimeve periodike për të pasqyruar drejtimet ose tendencat e reja të tregut.

Kliko linkun: <https://aida.gov.al/e-commerce.pdf>



KATALOGU “ALBANIA A TIMELESS TRIP”

Katalogu “Albania a Timeless Trip”- Pasqyron dhe prezanton objektet e ekspozuara në Pavijonin e Shqipërisë në Expo 2020 Dubai. Objektet e vendosura në pavijon shprehin kulturën, artin, natyrën dhe mundësitë e shumta që ofron vendi ynë.

Shfletoni katalogun “Albania a Timeless Trip” dhe njihuni vizualisht me objektet e ekspozuara në Pavijonin tonë, duke klikuar linkun: <https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/1214-katalog>

INFORMACIONE

PLATFORMA “DIGITAL TIRANA”

Digital Tirana është një iniciativë e ndërmarrë nga Drejtoria e Inovacionit, pjesë integrale e Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit, Inovacionit dhe të Dhënave në Bashkinë e Tiranës.

Kjo platformë sjell së bashku një sërë elementësh të sektorëve privat dhe publikë për të mbështetur startup-et, sipërmarrësit, aktorë të ekosistemit si dhe për të dhënë një informacion gjithëpërfshirës për nomadët digjitalë.

Platforma më e re Digital Tirana, përfshin të gjithë aktorët e ekosistemit në një faqe informative të vetme, ku edhe AIDA është pjesë e saj.

Për t'u njohur me platformën e re dhe projektet e publikuara, vizitoni linkun: <https://digitaltirana.al/rreth-nesh/>



DIGITAL TIRANA


STATISTIKA

EKSPORTET E MALLRAVE RRIKEN ME 50.5% NË MUAJIN SHKURT 2022

Sipas INSTAT, në muajin shkurt 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 37 miliardë lekë, duke u rritur me 50,5%, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me 22,3 %, “materiale e ndërtimit dhe metale” me 10,6 %, dhe “tekstile dhe këpucë” me 6,3 %.

Vendet me të cilat Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me muajin shkurt 2021 janë: Itali (57,5 %), Kosova (57,9 %) dhe Gjermania (3,3 herë).









AIDA


ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

 info@aida.gov.al  aida.gov.al  +355 (0)42 251 001  [@investinalbania](https://twitter.com/investinalbania)

 [@aida__albania](https://www.instagram.com/aida__albania)  [AIDA - Albanian Investment Development Agency](https://www.facebook.com/AIDA-Albanian-Investment-Development-Agency)

 [AIDA - Albanian Investment Development Agency](https://www.linkedin.com/company/AIDA-Albanian-Investment-Development-Agency)